

# Raporti i Vlerësimit të jashtëm Universiteti i Prizrenit

---

Raporti përfundimtar  
1 qershor 2012

1. Hyrje .....	4
1.1. Konteksti.....	4
1.2. Ekspertët.....	4
1.3. Shkurtesat e përdorura .....	4
1.4. Procedura dhe mbledhja e dëshmime .....	5
1.4.1. Raporti i Vetë-Vlerësimit (RVV).....	5
1.4.2. Vizita në Institucion .....	5
1.4.3. Dokumentet Shtesë.....	6
2. Vlerësimi institucional.....	7
2.1. Deklarata e Misionit dhe Strategjia .....	7
2.2. Organizimi dhe Menaxhmenti.....	8
2.3. Personeli, caktimi i personelit, zhvillimi i personelit .....	8
2.4. Financat .....	9
2.5. Plani Zhvillimor.....	9
2.6. Puna kërkimore dhe liria akademike.....	9
2.7. Mjediset dhe Pajisjet.....	10
2.8. Menaxhimi i Cilësisë .....	11
2.9. Ndërkombëtarizimi.....	11
2.10. Plotësimi i rekomandimeve të EE.....	11
2.11. Reflektimet e Studentëve dhe të Personelit Mësimdhënës.....	11
2.12. Planet e studimit dhe rregulloret e pranimit.....	12
3. Programet e Studimit.....	13
3.1. Menaxhim Ndërkombëtar, Administrim Biznesi (të dyja riakreditim) .....	13
3.1.1. Hyrje.....	13
3.1.2. Programi i Studimeve “Menaxhim Ndërkombëtar” në Nivelin Bachelor .....	14
3.1.3. Programi Studimor “Administrim Biznesi” në Nivel Bachelor.....	16
Rekomandimet.....	18
3.2. BSc. Dizajn Softueri (riakreditim) dhe BSc. Teknologji Informative dhe Telekomunikim (riakreditim) .....	19
3.2.1. Vërejtje të Përgjithshme.....	19
3.2.2. Të qenit në përputhje me Rekomandimet Pararendëse.....	19
3.2.3. Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve .....	20
3.2.4. Mësimdhënie .....	20
3.2.5. Puna kërkimore .....	21
3.2.6. Personeli.....	21
3.3. Gjuhë dhe Letërsi Gjermane (riakreditim).....	23
3.3.1. Vërejtje hyrëse .....	23
3.3.2. Deklarata e Misionit .....	23
3.3.3. Liria Akademike.....	23

3.3.4 Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve .....	24
3.3.5 Puna Kërkimore .....	25
3.3.6 Bashkëpunimi Ndërkombëtar .....	26
3.3.7 Personeli.....	26
3.4 Master në Trashëgiminë Kulturore dhe Menaxhim të Turizmit (akreditim i parë) ...	27
3.4.1 Vërejtje të përgjithshme.....	27
3.4.2 Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve .....	27
3.4.3 Mësimdhënia .....	28
3.4.4 Puna kërkimore .....	29
3.4.5 Personeli.....	29
3.5 Programi Drejtësi (BA) në universitetin publik të rizrenit .....	31
3.5.1 Hyrje.....	31
3.5.2 Kurrikula.....	31
3.5.3 Personeli .....	33
3.5.4 Propozim për vendimin për akreditim .....	33

## 1. Hyrje

### 1.1. Konteksti

Ky dokument përfshin raportin përfundimtar të vlerësimit 2012 në lidhje me Universitetin Publik të Prizrenit, Kosovë. Dokumenti është rezultat i punës së përbashkët të një ekipi ekspertësh (EE) ndërkombëtarë të caktuar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AAK) për të vlerësuar menaxhimin institucional dhe të programeve të studimit të UiPz. Raporti bazohet në Raportin e Vetë-Vlerësimit (RVV) të Universitetit të Prizrenit, në vizitën e EE në Prizren më 15 maj 2012, një takim me menaxhmentin e programit të gjuhës dhe letërsisë gjermane më 16 maj 2012 në Prishtinë dhe informatave shtesë të pyetura nga EE në lidhje me UiPz,.

### 1.2. Ekspertët

EE përbëhej nga ekspertët në vijim:

- Prof. Dr. Erwin Bratengeyer, Universiteti i Danubit, Krems, Austri
- Em.O. Univ.-Prof. Dr. Christian Brünner, Universiteti i Gracit, Austri
- Prof. Dr. Paraskeva Ilieva Dimitrova, Instituti i Ekonomisë, Akademia e Shkencave e Bullgarisë, Sofje, Bullgari
- Prof. Dr. Volker Frederking, Universiteti i Erlangenit-Nymberg, Gjermani
- Prof. Dr. Konrad Clewing, Instituti për Hulumtime Lindore dhe të Evropës Jugore, Regensburg, Gjermani

### 1.3. Shkurtesat e përdorura

Shkurtesat e cekura në vijim janë përdorur në dokument:

AAK	Agjencia e Akreditimit e Kosovës
AL	Arsim i Lartë
EE	Ekipi i Ekspertëve
RVV	Raporti i Vetë-Vlerësimit
SC	Sigurimi i Cilësisë
TI	Teknologji Informative
UiPz	Universiteti i Prizrenit
UiP	Universiteti i Prishtinës
VNI	Vizita në Institucion

## 1.4. Procedura dhe mbledhja e dëshmimeve

### 1.4.1. Raporti i Vetë-Vlerësimit (RVV)

UiPz ka dorëzuar një RVV të detajuar, të përbërë nga 183 faqe si dokument kryesor për akreditimin institucional. Raporti ka përshkruar gjendjen siç ka qenë në mes të prillit 2012.

RVV iu ka mundësuar EE të fitojnë në pamje të qartë në lidhje me gjendjen e tanishme në Universitet dhe ka qenë një bazë informative e mirë për t'u përgatitur për VNI, megjithëse disa kapituj siç janë deklaratat e misionit (f. 17) ose hulumtimet (f. 169-170) janë disi të shkurtër dhe të përgjithësuar.

Veç raportit institucional, UiPz ka dorëzuar një kurrikulë të ndryshuar për 5 programe bachelor që është dashtë të riakreditohen si dhe një kurrikulë të re për 1 program të propozuar në nivelin master.

### 1.4.2. Vizita në Institucion

Më datë 14 maj, EE u takuan në mbrëmje dhe patën një darkë pune preliminare. Ata folën në lidhje me vlerësimet e tyre të para në lidhje me RVV dhe në lidhje me programin për VNI ditën në vijim.

Më datë 15 maj, EE kaloi një ditë në Prizren, të shoqëruar nga Prof. Dr. Ferdije Zhushi-Etemi, kryetare e Bordit të Akreditimit të AAK si dhe Magjistër Basri Muja – Drejtori i AAK. Duke qenë se ishte i sëmurë, Prof. Brünner nuk pati mundësi të marrë pjesë. VNI u zhvillua ashtu siç ishte planifikuar, me përjashtim të takimit me përfaqësuesit e programit të studimeve të gjuhës dhe letërsisë gjermane. Si rrjedhojë e një keqkuptimi të madh Menaxhmenti i programit të studimeve nuk kishte kuptuar se edhe ata ishin të ftuar për takim me grupin e ekspertëve. Për këtë arsye Prof. Dr. Ferdije Zhushi – Etemi kërkoi nga eksperti i jashtëm në lidhje me Gjuhën dhe Letërsinë Gjermane (Prof. Frederking) nëse ai do të pranonte të zhvillohej një takim shtesë me përfaqësuesit e departamentit ditën në vijim në Prishtinë. Eksperti pranoi datën e re. Takimi me përfaqësuesit e programit të studimeve, ekspertit dhe Prof. Dr. Zhushi-Etemi u zhvillua më 16 maj në ora 9 në mëngjes, në Prishtinë.

VNI e përcaktuar për mëngjesin e 15 majit, filloi në kohë me një intervistë të gjatë me personelin e ri menaxhues të Universitetit, që mes të tjerash përbëhej nga Rektori, Prorektori dhe drejtorët e programeve të tanishme të ndryshme të studimeve. Kjo u përcoll nga një vizitë në fakultete, administratë dhe mjedise.

Pas drekës së punës, EE u nda në dy nën-grupe me qëllim që t'i intervistojë përfaqësuesit e programeve të ndryshme që kishin të bënin me akreditim, respektivisht me procedurën e riakreditimit. Në një rast të veçantë mungonte personi përgjegjës për programin e studimeve. Në fund EE pati dy sesione të shkurtra intervistimi me studentë dhe me personelin mësimdhënës.

EE do të donte të shprehte mirënjohjen ndaj UiPz për organizimin shumë të mirë të vizitës. Veç kësaj, EE falënderon në mënyrë të sinqertë AAK për dy përfaqësuesit e saj

kryesorë, për mbështetjen e jashtëzakonshme dhe bashkëpunimin, par gjatë dhe pas vizitës.

#### 1.4.3. Dokumentet Shtesë

Gjatë sesioneve të intervistave në lidhje me programet, u kërkuan dokumente shtesë në lidhje me një program përveç versionit të ndryshuar të skemës organizative. Më vonë EE kërkoi nga AAK dokumente shtesë dhe ato u dërguan shumë shpejt.

## 2. Vlerësimi institucional

Vlerësimi institucional është sipas dokumenteve Standardet i AAK, ky i fundit i bazuar në rregulloret ligjore dhe udhëzimet administrative.

Disa standarde janë adresuar në mënyrë të përbashkët dhe rendi i tyre mund të ndryshojë nga ai i përdorur në dokumentin e AAK.

### 2.1. Deklarata e Misionit dhe Strategjia

Universiteti Publik i Prizrenit është themeluar në vitin 2010 si rrjedhojë e një vendimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Është menduar që UiPz do të jetë homologu jugor i Universiteti Publik të Prishtinës që është më i vjetër dhe shumë më i madh se ai. Profili i UiPz do të duhej të ishte i një Universiteti të Shkencave Aplikative.

Në krahasim me gjendjen e UiPz të qershorit 2011, tashmë kishte sinjale të qarta që Menaxhmenti i ri i UiPz që kishte filluar në vjeshtë 2011 ka qenë i suksesshëm në stabilizimin e kushteve të punës për gjithë personelin e UiPz në mësimdhënie dhe në punë kërkimore. Kjo duhet të theksohet si një arritje e madhe e menaxhmentit të ri. Rekomandimi i ekspertëve për të riformuluar deklaratën e misionit dhe strategjinë e Universitetit është realizuar në përgjithësi. Tri fushat kryesore të aktiviteteve të Universitetit (rajoni, vendi dhe përtej) janë pjesë e RVV 2012.

Megjithatë, siç ishte rasti edhe me RVV e 2011, synimet themelore të UiPz janë formuluar vetëm në mënyrë të përgjithësuar edhe në RVV e 2012. Përveç synimit të arritjes së cilësisë së lartë në ligjërime, mësimdhënie dhe në përputhje me programet, është caktuar një fokus në lidhje me nevojat dhe tregun e punës në Kosovë dhe në vendet tjera. Këto aspekte janë pjesë specifike e synimit për të zhvilluar një identitet specifik të universitetit. Një synim tjetër kryesor i menaxhmentit të UiPz është që të bëhet i pavarur në çështjet financiare.

Por, nuk mund të shpërfilllet që në RVV e 2012 rrallëherë përkruhet strategjia në mënyrë të detajuar. Siç ndodh shpesh në universitetet e reja, diskutimet strategjike përdoren më shumë si një mënyrë e shprehjes së ambicieve të mëdha dhe të gjëra, në vend se të bëhen përpjekje të jepet një pamje e qartë në lidhje me ndryshimet në fazën afatmesme. Këto konsiderata sigurisht se janë më të qarta, megjithatë ato duket se janë më të dobishme.

Sigurisht që EE kupton shumë mirë që puna e përditshme për të ngritur dhe mbajtur Universitetin ka konsumuar një pjesë të mëdha të energjive që do të mund të shpenzoheshin në përgatitjen e të ardhmes afatshkurtër: është e vështirë të thuhet se çfarë do të ndodhë gjatë javës së ardhshme nëse mundohesh të mbijetosh vetëm deri nesër. Në lidhje me këtë, deklaratat e EE do duhej të kuptoheshin gjithnjë si sugjerime në vend se kritika të thjeshta.

EE rekomandon të bëhet përsëri një specifikim i deklaratës së misionit dhe strategjisë së Universitetit. Të gjithë pjesëtarët e personelit, ose të paktën të gjithë drejtorët e programit do të duhej të përfshiheshin sa më shumë që të jetë e mundur në reflektimin e mëtejshëm të strategjisë. Ka poashtu nevojë për të thelluar profilin kërkimor të gjithë universitetit.

## 2.2. Organizimi dhe Menaxhmenti

Që nga vjeshta e vitit 2011 Universiteti i Prizrenit ka një menaxhment të ri me Rektorin Prof. Dr. Mazllum Baraliu, Pro-Rektorin Prof. Dr. Behxhet Mustafa dhe Zyrtarin për Sigurimin e Cilësisë Jasmin Jusufi. "Skema e përkohshme e organizimit" e dhënë (f. 19) ilustron strukturat kryesore të organizimit dhe të përgjegjësive në UiPz: I. Kabinetin e Rektorit; II. Administrata Qendrore; III. Personeli Akademik. Fatkeqësisht, struktura politike e UiPz nuk është vizualizuar në skemën organizative. Për shembull mungon senati. Parlamenti i Studentëve nuk është integruar në skemën organizative.

EE rekomandon që skema organizative e UiPz të ndryshohet dhe të kompletohet. Senati dhe parlamenti i studentëve do të duhej të integroheshin në skemën organizative. Lexuesit poashtu do të duhej të informoheshin në lidhje me faktin që senati mbledhet një herë në muaj dhe që studentët janë pjesë e senatit.

## 2.3. Personeli, caktimi i personelit, zhvillimi i personelit

Gjatë takimit me EE Rektori ceku faktin se cilësia ka qenë kriteri kryesor i kontratave të reja të punësimit që nga momenti kur ka filluar të punojë Menaxhmenti i ri. Shumica e personelit akademik janë të ri dhe mjaft të kualifikuar. RVV 2012 e UiPz (f. 25-27) tregon faktin që universiteti në fakt ka 77 mësimdhënës akademikë. Megjithatë, rektori shpjegoi se mes tyre ka rreth 50 profesorë të Universitetit të Prishtinës dhe universiteteve tjera. Kjo nënkupton se vetëm një pjesë e personelit akademik të UiPz janë të pranishëm gjithnjë në Prizren. Një arsye për këtë është fakti se UiPz nuk ka lirinë që të punësojë personelin në mënyrë të pavarur, që është një çështje konstituive për një institucion normal të këtij tipi. Si rrjedhojë e marrëveshjes në mes Ministrit dhe UiPz, pjesëtarët e personelit të caktuar në vitin 2011 kanë pranuar kontratat për vetëm një vit. Kjo nënkupton se të gjitha pozitat do të rihapen dhe do të shpallen për vitin 2012-2013. Ky kufizim i kontratave të reja për një vit është ende një problem i madh. Përsëri, EE thekson efektet e dëmshme të një pasigurie të tillë.

Siç është cekur tashmë në raportin e EE të vitit 2011, është thënë se ngritja e personelit do të mbetet çështje kryesore për të ardhmen e UiPz. Është i nevojshëm një plan i përgjithshëm i mbështetjes, ky plan do të adresonte mënyrat konkrete përmes të cilave UiPz do t'i ndihmonte pjesëtarëve të vet të personelit në ngritjen e kualifikimeve të tyre. Së pari, në vitet në vijim, është mjaft e qartë se tituj akademikë të masterit dhe të PhD mund të fitohen vetëm në institucionet tjera të AL. Ky fakt paraqet një problem të koordinimit në mes UiPz dhe kohës së studimeve/kërkimeve në institucionet tjera. Në lidhje me marrëveshjet për rastet e tilla, duhet të sigurohet që të gjithë pjesëtarët e personelit janë të trajtuar në mënyrë të njëjtë.

Veç kësaj, do të duhej të ishte detyrë e menaxhmentit të Universitetit të krijojë kushtet e nevojshme për punë kërkimore në UiPz (shumica e tyre e aplikuar). Kjo do të adresohet në seksionin në vijim 2.6.

Të paktën në një perspektivë 2-3 vjeçare, UiPz do t'i duhet që të krijojë një kornizë për trajnim të personelit të vet. Kjo mund të realizohet në mënyrë produktive dhe harmonike posa që pjesëtarët e personelit të kenë nënshkruar kontrata të qëndrueshme me kohëzgjatje më të madhe se një vit.



EE rekomandon që UiPz të miratojë një dokument zyrtar ku do të cekeshin mënyrat se si do të inkurajoheshin pjesëtarët e personelit në vijimin e studimeve të tyre të mëtejme në institucionet tjera. Veç kësaj EE rekomandon që periodha e kontratës nuk do të duhej të ishte më e shkurtër se tri vjet.

## 2.4. Financat

Si rrjedhojë e mungesës së statusit legal, që do të mund të jepej përmes një vendimi të parlamentit, UiPz nuk i është dhënë përgjegjësia për buxhetin e tij. Të gjitha shpenzimet mbulohen drejtpërdrejt nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kjo sigurisht se vë kufizimet në lidhje me ngritjen e agjendës së Menaxhmentit të Universitetit. Sigurisht që EE pohon faktin se është veçanërisht e vështirë që në këto rrethana të vazhdohet puna në mënyrë normale.

Për këtë arsye, duhet të arrihet autonomia financiare nga ana e universitetit dhe kjo në të ardhmen e afërt. Si një pikë fillestare e duhur, RVV përmban dhe kjo në përputhje me rekomandimet e EE 2011 një deklaratë financiare të strukturuar mirë në lidhje me nevojat financiare të Universitetit dhe burimeve financiare për tri vitet e ardhshme (2013-2015). Plani i buxhetit tregon se universiteti në fakt ka nevojë për 3.029.387,00 Euro. Në vitin 2015 Menaxhmenti pret një rritje deri në 4.861.539,00 Euro.

EE sërish rekomandon fuqishëm që nga organet politike të autorizuar të merren vendimet e nevojshme politike në lidhje me autonominë themelore të një Universiteti siç është UiPz. EE më tej i rekomandojnë UiPz që buxhetet preliminare për nevojat e ndryshme infrastrukturore të përpilohen në mënyrë zyrtare dhe hap pas hapi të përmirësohet shkalla e të hyrave vetanake në vitet në vijim.

## 2.5. Plani Zhvillimor

Përderisa perspektiva dhe deklarata strategjike e RVV 2011 ka qenë një përzierje e masave emergjente ditë pas dite që duhet të ndërmerren në mënyrë që Universiteti të vazhdojë punën dhe vizionin e vetë afat-gjatë, RVV 2012 përmban ca përshkrime të zhvillimit të mëtejme. Ende nuk ka një "plan zhvillimor" që është cekur nga rektori i mëparshëm në fund të qershorit 2011, ose të paktën ai nuk ishte pjesë e RVV 2012. Dokumenti cek vetëm disa deklarime të përgjithësuara. Për të ngritur profile siç janë mjekësia, bujqësia dhe pedagogjia, duhet të ofrohen sqarime shtesë.

EE përsëri rekomandon që sa më shpejt që të jetë e mundur të përfundohet plani zhvillimor, ky i fundit do të ndahet në synime modeste, secila nga to të kishte strukturën në vijim, që haset në dokumente të tilla:

- definimi i objektivit specifik
- masave për të arritur një objektiv të tillë
- indikatorëve që mundësojnë përcjelljen e arritjes së objektivit

Poashtu, është e nevojshme që plani i cekur të përcillet në mënyrë adekuate të të gjithë personat me interes në UiPz.

## 2.6. Puna kërkimore dhe liria akademike

Siç është cekur në mënyrë të hapur në RVV 2012 (f. 170), nuk ka gati aspak punë kërkimore që realizohet në UiPz. Më herët ishin ngritur gjashtë qendra të punës

kërkimore, por ato nuk janë në funksion si rrjedhojë e mungesës së resurseve. Sipas informatave të vëna në dispozicion nga ana e rektorit gjatë VNI, këto qendra janë mbyllur si rrjedhojë e mungesës së aktivitetit. Kjo nuk është një fakt për t'u çuditur në vitin e dytë pas themelimit. Por, për të ardhmen është e domosdoshme që UiPz dhe subjektet e tij të zhvillojnë strategji kërkimore dhe një profil të punës kërkimore. Synimi për ngritjen e duhur të një mekanizmi të mbështetjes universitare duhet të mirëpritet si një hap në këtë drejtim.

EE rekomandon sërish që puna kërkimore të integrohet në planin e zhvillimit në vijim. Fokusi duhet të vihet në hulumtimet e orientuara nga projektet dhe aplikimet. Ngritja dhe përdorimi i kontakteve me biznesin në rajon do të ishin të dobishme, me perspektiven që të bëjë puna kërkimore në emër të tyre.

## 2.7. Mjediset dhe Pajisjet

UiPz ka qenë mjaft i suksesshëm në përmirësimin e infrastrukturës së mësimin dhe mësimdhënies. Renovimi i ndërtesës së dytë i ofron studentëve dhe personelit akademik kushte të përmirësuara, që janë shumë të rëndësishme për atraktivitetin e UiPz.

Ka afërsisht njëqind kompjuterë në rrjetin e brendshëm, që përdoren qoftë për punë në klasa ose si qasje e papenguar në internet për studentët. Personeli i TI ka ngritur një platformë të e-mësimin, që është menduar të jetë si një projekt pilot që mund të zgjerohet në të gjitha programet studimore të UiPz. Kjo përpjekje është mjaft domethënëse duke qenë se një shumicë e madhe e studentëve kanë qasje Interneti në shtëpitë e tyre dhe që e-mësimi mund të konsiderohet si një kontribut për azhurnimin e mësimin. Megjithatë, aktivitetet e tanishme të e-mësimin janë ndërprerë dhe platforma e menaxhimit të mësimin Moodle nuk është në funksion. Kjo periudhë mund të përdoret për përditësimin e versionit të tejkaluar të platformës që përmban përmirësime të shumta (versioni aktual 2.2.3). Megjithatë, nuk ofrohet qasje në internet pa tela brenda Universitetit, por kjo është premtuar se do të ofrohet në të ardhmen e afërt.

Një problem akut paraqet qasja në burimet e literaturës, qoftë asaj fizike apo elektronike. Librat në bibliotekën universitare në të shumtën janë të trashëguara nga Fakulteti i Edukimit, ato janë në gjendje të mjerë dhe të padobishme për arsimim modern. Ka një mungesë të madhe në lidhje me literaturën gjermane, në Biznes dhe Menaxhim Ndërkombëtar dhe një mungesë të plotë të librave dhe revistave sa i përket TI.

Sa i përket resurseve elektronike, UiPz nuk ka qasje në databaza të mëdha në rrjet, as në databaza të hapura që ofrohen pa pagesë. Gjatë VNI, u cek disa herë dëshira për të pasur qasje në të paktën një nga revistat ndërkombëtare që publikohen në rrjet, kjo dëshirë u shpreh veçanërisht nga pjesëtarët e personelit mësimdhënës.

EE sërish rekomandon që të pyeten të gjithë drejtorët e programeve në lidhje me librat më esencial apo resurset elektronike në fushën e tyre dhe të ceken një vlerësim nëse mjetet janë në dispozicion në buxhet. Poashtu rekomandohet që pjesëtarët e bibliotekës të informohen në lidhje me dispozicionin e databazave në rrjet.

Rekomandohet që të bëhet riaktivizimi i versionit të azhurnuar të platformës së menaxhimit të mësimin dhe të përfshihen në mënyrë graduale në proceset e mësimdhënies.

## 2.8. Menaxhimi i Cilësisë

Menaxhmenti i ri i UiPz është fokusuar në çështjen e menaxhimit të cilësisë, kjo në përputhje me rekomandimin e EE. Themelimi i Zyrës së Sigurimit të Cilësisë (ZSC) në bashkëpunim me përfaqësuesit e TEMPUS dhe të WUS Kosova paraqet një sinjal të qartë progresi. Parimi udhëheqës i ZSC është bindës. Vlerësimi duhet të paraqesë një instrument të përhershëm të menaxhimit të cilësisë. Monitorimi dhe Zhvillimi mund të jenë baza për arritjen e mësimdhënies, të mësimi dhe të punës kërkimore në UiPz.

Zhvillimi i vlerësimeve paraqet një instrument shumë mbështetës për sigurimin e cilësisë. Megjithatë, vetëm anketimet anonime mund të mundësojnë përgjigje autentike.

EE rekomandon që Sigurimi i Cilësisë do të duhej integruar përmes planit të ri të zhvillimit. Rekomandohet që anketimet, të cilat zhvillohen si pjesë e programit të sigurimit të cilësisë të bëhen në mënyrë anonime.

## 2.9. Ndërkombëtarizimi

UiPz ka përmirësuar rrjetëzimin e vet ndërkombëtar. Ka partneritete të arritura me disa universitete në Gjermani, Austri, Turqi, Indi, Shqipëri dhe Bosnje, por ka ende një rrugë të gjatë që duhet të përshkohet për të arritur bashkëpunime të qëndrueshme. RVV 2012 (f. 169) jep një pasqyrë të detajuar. Është premtuar përpilimi i një plani për ndërkombëtarizim.

EE rekomandon përfundimin e shpejt të planit strategjik në lidhje me ndërkombëtarizim dhe që po i njëjti të integrohet në planin e pritshëm të zhvillimit. Përmirësimi i dukshmërisë ndërkombëtare të UiPz paraqet një hap shumë të rëndësishëm. Për këtë arsye është shumë me rëndësi që të bëhet përkthimi i faqes së internetit në anglisht dhe kjo gjatë muajit të ardhshëm.

## 2.10. Plotësimi i rekomandimeve të EE

Thënë në përgjithësi, janë zbatuar shumë nga rekomandimet e raportit pararendës të EE 2011. Megjithatë, ka disa çështje që ende kanë mbetur zvarrë. Rekomandimet që nuk janë pranuar vihen në pah përsëri.

EE rekomandon që çështjet e mbetura hapur duhet të plotësohen në muajt në vijim.

## 2.11 Reflektimet e Studentëve dhe të Personelit Mësimdhënës

EE pati rastin të takojë 11 studentë në vitin e parë dhe të dytë nga katër fakultetet. Ngjashëm, një takim u zhvillua edhe me personelin mësimdhënës që përfaqësonte të gjitha fakultetet.

Studentët pohuan që UiPz ka bërë një përparim që nga fillimi. Shumica e tyre ishin të frustruar në vitin e tyre të parë, megjithatë, ata pranojnë se në vitin e dytë kushtet janë përmirësuar mjaft. Ata vlerësojnë infrastrukturën dhe aftësitë mësimdhënëse të ligjëruesve. Në mënyrë të veçantë ata çmojnë kontaktin e drejtpërdrejtë mbështetës të shumicës së personelit mësimdhënës.

Në anën tjetër, ata ankohen në lidhje me çështjet infrastrukturore dhe mungesën e shkathtësive mësimdhënëse të disa mësimdhënësve. Sipas studentëve, ka mungesë të qasjes në internet, qoftë në rrjetin pa tela apo në PC në rrjet. Ata poashtu ankoheshin në

lidhje me qasjen mjaft të kufizuar në kabinetet e kompjuterëve. Është për t'u çuditur që asnjë student nga ky grup nuk ka pasur qasje në bibliotekë e as nuk ka marrë ndonjëherë një libër të vetëm. Kishte ankesa në lidhje me metodat e mësimdhënies së vjetruar, mungesën e aftësisë së të folurit të anglishtes (nuk kishte folës që këtë gjuhë e flasin si gjuhë amtare) dhe nuk kishte përdorim të teknologjive arsimore. Në disa raste thuhej se klasat mësimore ishin tepër të mëdha dhe numri i personeli mësimor ishte i vogël.

Thënë në përgjithësi, personeli mësimor pohonte përmirësimet substanciale në krahasim me vitin e parë të operimit që ishte përcjellë me shumë vështirësi. Në ndërkohë, duket se zhvillohen takime të rregullta në nivel menaxheria që duket se shërbejnë si masa për ngritjen e vetëbesimit. Në nivelin e mësimdhënësve, resurset e reja mundësonin fokusimin në proceset mësimdhënëse dhe në përmirësimin e programeve. Natyrisht se ka hapësirë për përmirësime të mëtejme dhe janë ngritur disa brenga që rezultojnë në rekomandimet në vijim:

Rekomandohet që

- të përcaktohet një personel akademik i mjaftueshëm dhe i rregullt,
- të përmirësohet shkëmbimi me universitetet tjera,
- të ngrihen kompetencat e personelit mësimor, duke përfshirë njohjen e mirë të anglishtes, të ofrohet literatura adekuate për secilën lëndë,
- të publikohen vendet e lira dy herë në vit, poashtu për asistentët e jo vetëm për profesorët e rregullt,
- të ofrohet më shumë hapësirë për vitet në vijim,
- të ofrohen kontrata me periudha më të gjata në mënyrë që të ngrihet motivimi,
- të ofrohen burime dhe kushte që mundësojnë aktivitete hulumtuese,
- të ofrohen kushte themelore që largojnë punën e tepërt,
- të rifutet lënda në lidhje me punën ekipore.

## 2.12. Planet e studimit dhe rregulloret e pranimit

Planet individuale të studimit për programet e ndryshme që janë të ndërlidhura me procedurën e akreditimit janë të adresuara në kapitullin në vijim.

Në përgjithësi, EE fitoi një përshtypje të mirë në lidhje me shumicën e kurrikulave të prezantuara nga UiPz. Në krahasim me RVV të 2011, duket se rezultatet e mësimit janë të përcaktuara në një mënyrë standarde. Rregullat sa i përket përcaktimit të kredive ECTS janë koherente. Kjo tregon se drejtorët e programit dhe ekipet e tyre kanë pasur një kornizë të përbashkët kur kanë punuar programet studimore.

### 3. Programet e Studimit

Pjesë të ndryshme të programeve të studimit që ishin të ndërlidhura me procedurën akredituese janë shkruar nga pjesëtarë të ndryshëm të EE. Si rrjedhojë, ato mund të ndryshojnë në lidhje me strukturën dhe formën e tyre.

#### 3.1 Menaxhim Ndërkombëtar, Administrim Biznesi (të dyja riakreditim)

##### 3.1.1. Hyrje

UiPz dëshiron të akreditojë dy programet e tij studimore: "Menaxhim Ndërkombëtar" dhe "Administrim Biznesi" në nivelin Bachelor. Në RVV të UiPz ka informata në lidhje me këto programe studimi, por ato nuk mjaftojnë që të përpilohet një raport i plotë dhe i detajuar, që do të reflektonte aktivitetet e vërteta të kolegjit. Për këtë arsye paraqitet nevoja për të kërkuar informata në lidhje me çështjet në vijim:

1. Çfarë do të shkruhet si specializim në diploma të studentëve që tashmë kanë përfunduar edukimin e tyre në programin e studimeve në Administrim Biznesi?
2. Çfarë lloj testesh janë përdorur në fusha të ndryshme të ekonomisë në të gjitha lëndët e parapara për studim në UiPz?
3. Sa studentë do të arsimohen në këto programe studimesh që ofron UiPz në vitet në vijim?
4. Cili fakultet mendohet se do të ofrojë studime të rregullta dhe cili me korrespondencë dhe si? Ju lutem shkruani se cilët ekspertë do të japin mësim në cilat lëndë?
5. Cili është proporcioni numerik në mes profesorëve, profesorëve të asocuar, kolegëve dhe kandidatëve për doktoratë në lidhje me 100 studentë në ekonomi?
6. Çfarë mëton të ndryshojë Menaxhmenti i UiPz në kurrikulën e tyre? A synon UiPz që të vazhdojë me trajnimin në lëndët ekonomike në pesë semestrat e para?
7. A do të vihet fokusi në mësimdhënien e anglishtes në pjesën e dytë?
8. Mbi çfarë baze janë caktuar lëndët e duhura?
9. Cila pjesë e fakultetit ekonomik prezanton punime në konferenca, simpoziume, forume, etj qoftë brenda apo jashtë vendit?
10. Cilat lloje publikimesh (libra, artikuj, studime) janë bërë nga fakultetet në 2009-2011?
11. A ka profesorë të UiPz dhe personel tjetër akademik që kanë qenë jashtë vendit në specializime dhe sa kohë kanë kaluar në periudhën 2009-2011?
12. Si synon UiPz që të ofrojë literaturë për arsimim të studentëve duke qenë se biblioteka tani ka vetëm 130 libra, duke përfshirë edhe revistat?
13. Cilat janë arsyet me të cilat mëton t'i joshë studentët për të studiuar në UiPz?

Këto pyetje janë përgjigjur pas takimit me menaxhmentin në një mënyrë të mjaftueshme. Mbi këtë bazë ka qenë e mundur që të shkruhej raporti në vijim.

### 3.1.2. Programi i Studimeve “Menaxhim Ndërkombëtar” në Nivelin Bachelor

Analiza e aktiviteteve të studentëve në programin e studimeve “Menaxhim Ndërkombëtar” është bazuar në RVV të UiPz, informatat shtesë dhe përshtypjet nga takimi me disa nga anëtarët e UiPz më 15.05.2012 në lidhje me kërkesën e tyre për akreditimin e dy programeve të studimit.

Misioni i mësimdhënies për studentë në këtë program studimesh është formuluar në f. 28 si: “t’i ofrojë studentëve një mendim të fuqishëm të konceptit dhe të zgjidhjes së problemeve përmes kuptimit dhe aplikimit të aftësive menaxheriale në problemet reale”. Shoqëria dhe ekonomia kosovare kanë nevojë për specialistë të mirë me aftësi të kualifikuara në fushën e sferës ekonomike, financiare, të marketingut. Kjo do të realizohet përmes ndihmës së “njohurive teorike dhe praktike që kanë për synim përgatitjen e studentëve në mënyrë cilësore në përputhje me kërkesat e profesionit dhe me tendencat”. Ky mision është i duhur dhe i qartë. UiPz për të arritur këtë synim duhet që të ketë “personel akademik të kualifikuar dhe një mjedis për mësimdhënie dhe aktivitete mësimore”.

UiPz duhet të mbajë procedura për zhvillim, përmirësim, observim dhe ripërtëritje të dokumenteve arsimore (karakteristikat e kualifikimit të subjekteve, kurrikulave dhe planprogrameve) për mësimdhënie të studentëve.

#### 3.1.2.1. Studentët

UiPz ka një përvojë të shkurtër (vetëm 2 vite akademike) në mësimdhënie studentëve. Numri i studentëve në këtë program studimesh në periudhën 2010-2012 është cekur në Tabelën 1:

Diploma	2010-2011	2011-2012	Total	Të dështuar		Nr total i studentëve	Total	
				2010-2011	2011-2012	2010-2011	2011-2012	
Menaxhim Ndërkombëtar	201	174	375	12		213	194	407

Ky program studimesh “Menaxhim Ndërkombëtar” në nivelin Bachelor zgjat 3 vjet ose 6 semestra. Studentët në këtë program studimor në nivelin bachelor duhet t’i grumbullojnë të paktën 180 kredi ose një minimum prej 30 kredish për secilin semestër. Një kredi korrespondon me një vlerë prej 15-25 orësh ngarkese, që përfshin ngarkesën e përgjithshme sa i përket “leximit, detyrave në shtëpi, shkrimit, detyrave, pjesëmarrja në ligjërata dhe provime.”

Në tabelën 2, ka informata në lidhje me lëndët obligative dhe zgjedhore për programin e studimeve “Menaxhim Ndërkombëtar”, në përputhje me semestrin dhe vitin.

Programet e Studimeve	Semestrat			Total
	I dhe II	III dhe IV	V dhe VI	
Lëndët Obligative	13	12	9	34
Lëndët Zgjedhore	2	2	2	6

Lëndët obligative janë të tepërta. Nuk duhet të jenë më shumë se 30. Numri i lëndëve zgjedhore është i mjaftueshëm, por mund të rritet.

Njohuritë në lidhje me matematikën elementare duhet të studiohen në mënyrë të shtuar. Në këtë lëndë duhet të përfshihen metodat e aplikimit dhe modelet në matematikë, por jo edhe njohuritë nga shkolla e mesme në Matematikë.

Përshkrimi i përmbajtjes së disiplinave për disa nga lëndët nuk është i kompletuar. Për shembull lëndët “Vendim-marrja në biznes” dhe “Menaxhimi Ndërkombëtar” duke pasur vetëm nga një libër pa informata në lidhje me vitin apo informatat tjera. Është e nevojshme që të shtohet ky informacion.

### 3.1.2.2. Personeli Akademik

Në faqen 4 të RVV të UiPz në tabelën 2 “Të dhëna për programin e studimeve: “Menaxhim Ndërkombëtar”” është cekur se personeli i rregullt akademik përbëhet nga tre Profesorë Asistentë dhe një udhëheqës i programit të studimeve – 1 profesor asistent ose në total numri prej 4. Por në faqen 25 në tabelën 6 “Personeli” nga RVV është cekur se Personeli Akademik prej 25 anëtarësh si dhe personeli Akademik për mësimdhënie dhe studentë në dy programe studimesh. Megjithatë, ky personel nuk është i mjaftueshëm për trajnimin e studentëve. Nuk ka asnjë informatë në lidhje me cilësinë e përmbajtjes e as kush janë këta anëtarë në kuptim të orarit të plotë apo profesorëve me orar jo të plotë. As në informatat shtesë poashtu nuk ka të dhëna.

Nëse i pranojmë këto informata si korrekte, ne mund të krijojmë një ndërlidhje në mes studentëve dhe personelit akademik. Numri i studentëve për një person të personelit akademik është 14,45. Ky informacion na tregon se është e nevojshme rritja e numrit të personelit akademik.

Aktiviteti publikues i personelit akademik – Në lidhje me këtë ka shumë pak informata.

Aktiviteti në publikime i pjesëtarëve të këtij programi studimesh është një kusht i rëndësishëm për grumbullimin e njohurive dhe përvojave (veçanërisht për kolegët e rinj) që i mundëson atyre të përditësojnë ligjëratat e tyre dhe t’i bëjnë ato relevante. Vetëm dy profesorë marrin pjesë në konferenca dhe punëtori qoftë jashtë vendit apo në Kosovë. Për shembull prof. Dr. Hamiti ka marrë pjesë në 16 konferenca, 3 punëtori dhe ka publikuar 27 punime. Prof. Asistent Brajshori ka marrë pjesë në 3 konferenca, ka publikuar një libër dhe ka marrë pjesë në projekte ndërkombëtare (këto informata janë marrë nga të dhënat shtesë).

Rekomandimi është: Personeli akademik duhet të bëjë hulumtimet e veta dhe më pastaj t’i publikojë ato në libra, studime, punime, të marrë pjesë në konferenca, simpoziume dhe kështu me radhë.

### 3.1.2.3. Ofrimi i Materialit për mësim

Në UiPz ka mjaft kompjuterë dhe Universiteti mëton të vazhdojë blerjen e kompjuterëve shtesë dhe mjeteve tjera teknike. Në UiPz ka mjaft klasë mësimore me mjete multimediale në to.

### 3.1.3. Programi Studimor “ Administrim Biznesi ” në Nivel Bachelor

Analiza e aktiviteteve të studentëve në programin e studimeve “ Administrim Biznesi ” është e bazuar në RVV të UiPz, në informatat dhe përshtypjet shtesë nga takimet me disa nga pjesëtarët e UiPz të datës 15.05.2012 në lidhje me kërkesën e tyre për akreditimin e dy programeve studimore.

Misioni për të dhënë mësim studentëve në këtë program studimesh është formuluar në f. 42 si: “ t’i ofrojë studentëve mundësi për të vlerësuar kompleksitetin e organizatave vendore dhe ndërkombëtare të biznesit, ndërlidhjen që ekziston në mes biznesit dhe kornizave sociale në të cilat funksionon ai, si dhe sfidave të administratës në të gjitha nivelet ”. Ky mision është adekuat dhe i qartë.

Programi i studimeve realizohet në dy profile: “ BBA Specializim në Kontabilitet ” dhe “ Menaxhimi i Biznesit Agrikulturore ”.

Shoqëria dhe ekonomia kosovare kanë nevojë për specialistë të mirë me kualifikime në sferën e fushës së ekonomisë, financave dhe marketingut. Ai do të zbatohet me ndihmën e “ Njohurive praktike dhe teorike që kanë për synim përgatitjen cilësore të studentëve në përputhje me kërkesën e tregut dhe të tendencave ”. Kjo është arsyeja pse këto dy programe studimesh janë mjaft të rëndësishme për shoqërinë kosovare. Për të arritur këtë synim UiPz duhet të ketë “ personel akademik të kualifikuar dhe një mjedis adekuat për aktivitete të mësimdhënies dhe mësimit ”.

UiPz duhet të ketë procedura për ngritje, përmirësim, vëzhgim dhe ripërtëritje të dokumenteve arsimore (kualifikimet, karakteristikat e lëndëve, kurrikula dhe planprogrami) për mësimdhënie ndaj studentëve. Disa nga lëndët nuk janë pjesë përbërëse e lëndëve (p.sh Etika e Biznesit dhe Përgjegjësia Sociale ” (f. 56)).

#### 3.1.3.1. Studentët

UiPz ka një përvojë të shkurtër (vetëm 2 vite akademike) në trajnimin e studentëve. Numri i studentëve në këtë program studimesh në periudhën 2010-2012 është cekur në tabelën 3.

Diploma	2010-2011	2011-2012	Total	Të dështuar		Nr total i studentëve		Total
				2010-2011	2011-2012	2010-2011	2011-2012	
Menaxhim Ndërkombëtar	274	299	573	36	2	310	301	611

Ky program studimesh “ Menaxhim Ndërkombëtar ” në nivelin Bachelor zgjat 3 vjet ose 6 semestra. Studentët në këtë program studimor në nivelin bachelor duhet t’i grumbullojnë të paktën 180 kredi ose një minimum prej 30 kredish për secilin semestër. Një kredi



korrespondon me një vlerë prej 15-25 orësh ngarkese, që përfshin ngarkesën e përgjithshme sa i përket "leximit, detyrave në shtëpi, shkrimit, detyrave, pjesëmarrja në ligjërata dhe provime."

Në tabelën 4, ka informata në lidhje me lëndët obligative dhe zgjedhore për programin e studimeve "Menaxhim Ndërkombëtar", në përputhje me semestrin dhe vitin.

Programet e Studimeve	Semestrat			Total
	I dhe II	III dhe IV	V dhe VI	
Lëndët Obligative	13	13	Profili: BBA specializim në Kontabilitet – i: Profili: Menaxhim i Biznesit Agrikultural – 9	Profili: Specializimi BBA në Kontabilitet – 35; Profili: Menaxhimi i Biznesit Agrikultural – 36
Lëndët Zgjedhore	0	0	0	0

Lëndët obligative janë të tepërta. Nuk duhet të jenë më shumë se 30. Numri i lëndëve obligative për profilin Kontabilitet është 35 dhe për Menaxhim i Biznesit Agrikultural -36. Nuk ka asnjë lëndë zgjedhore. Kjo duhet të ndryshohet në vitet akademike në vijim. Është e nevojshme të cekën lëndët zgjedhore dhe të zvogëlohet numri i lëndëve obligative.

Njohuritë në lidhje me matematikën elementare duhet të studiohen në mënyrë të shtuar. Studentët që dëshirojnë të përkujtojnë njohuritë nga shkolla e mesme mund të përcjellin lëndë mësimore të veçanta. Në lëndën Matematikë, që përfshihet në planprogram, duhet të përfshijë metodat e aplikimit dhe modelet në ekonomi, e kështu në vijim.

Përshkrimi i përmbajtjes së disiplinave për disa lëndë nuk është i plotë. Për shembull lëndët "Vendim Marrja në Biznes" dhe "Menaxhimi Strategjik" nga përmbajtja kuptet se ka vetëm një libër për përgatitjen e studentëve për provime pa dhënë vit të publikimit apo informata tjera. Është e nevojshme që të shtohet ky lloj informacioni.

### 3.1.3.2. Personeli Akademik

Në faqen 4 të RVV të UiPz në tabelën 2 "Të dhëna për programin e studimeve: "Menaxhim Ndërkombëtar" është cekur se personeli akademik i përhershëm përbëhet nga tre profesorë asistentë dhe një udhëheqësi të programit të studimeve – 1 profesor asistent dhe një total prej 4. Por në faqen 25 në tabelën 6 "Personeli" në RVV është cekur se Personeli Akademik përbëhet nga 28 anëtarë si personel akademik për mësimdhënie të studentëve në dy programe studimesh "Menaxhim Ndërkombëtar" dhe "Administrim Biznesi". Megjithatë, ky personel nuk është i mjaftueshëm për mësimdhënie të studentëve. Nuk ka informacion në lidhje me cilësinë e përmbajtjes së tyre ose kush janë këta anëtarë sa i përket profesorëve të rregullt apo me orar jo të plotë.

Nëse ne pranojmë këtë informacion si të saktë, ne mund të krijojmë raportin numerik në mes studentëve dhe personelit akademik. Numri i studentëve për person akademik është 21, 82. Ky informacion na tregon se është e nevojshme të ngrihet numri i personelit akademik. Nëse ne kombinojmë numrin e studentëve nga të dyja programet e studimeve,

raporti numerik në mes studentëve dhe profesorëve është 36, 36. Ky rezultat është shumë i madh dhe kërkon rritjen e personelit akademik, duke qenë se ky personel akademik është i njëjti për të dyja programet e studimit.

Ka pak informacion në lidhje me publikimet e personelit akademik. Vetëm dy profesorë marrin pjesë në konferenca dhe punëtori jashtë dhe brenda Kosovës. Për shembull prof. Dr. Hamiti ka marrë pjesë në 16 konferenca, 3 punëtori dhe ka publikuar 27 punime. Prof. Asistent Brajshori ka marrë pjesë në 3 konferenca, ka publikuar një libër dhe ka marrë pjesë në projekte ndërkombëtare (këto informata janë marrë nga të dhënat shtesë).

Rekomandimi është: Personeli akademik duhet të bëjë hulumtimet e veta dhe më pastaj t'i publikojë ato në libra, studime, punime, të marrë pjesë në konferenca, simpoziume dhe kështu me radhë.

### 3.1.3.3. Ofrimi i materialeve për mësim

Në UiPz ka mjaft kompjuterë dhe Universiteti duhet të vazhdojë me blerjen e më shumë kompjuterëve dhe teknikës tjetër. Në UiPz ka mjaft klasë mësimi të pajisura me mjete multimediale në to. Baza materiale është e mjaftueshme për të dhënë mësim studentëve të vet.

## Rekomandimet

1. Të akreditohen dy programet e studimit "Biznes Ndërkombëtar" dhe "Administrim Biznesi";
2. Të përmirësohet përmbajtja sasore dhe cilësore e Personelit Akademik, që do të japin mësim në këto programe studimesh;
3. UiPz duhet të vazhdojë të sigurojë librat me tema ekonomike në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja për mësim të avancuar. Numri i librave tani për tani në bibliotekën e UiPz është vetëm 130 tituj në gjuhën shqipe. UiPz duhet të sigurojë tekste të shkruara nga profesorë që udhëheqin këto disiplina dhe të blihen më shumë libra në shqip dhe në gjuhë të huaja. Kjo do të sigurojë procesin edukativ.
4. Personeli akademik do të duhet të marrë pjesë në mënyrë aktive në përpilimin e projekteve kërkimore të financuara nga fondet në Kosovë dhe jashtë vendit, të marrë pjesë në punëtori dhe në forume tjera në vend dhe jashtë tij, duke kërkuar forma të ndryshme sponsorimi.

Pareskeva Dimitrova

28.5.2012

## 3.2 BSc. Dizajn Softueri (riakreditim) dhe BSc. Teknologji Informative dhe Telekomunikim (riakreditim)

### 3.2.1 Vërejtje të Përgjithshme

Që të dyja programet Dizajn Softueri dhe Teknologji Informative dhe Telekomunikim janë nisur në mënyrë të suksesshme dhe tashmë janë në vitin e dytë të ofrimit të tyre. Këto dy programe kanë të përbashkëta shumë karakteristika dhe menaxhohen në mënyrë të përbashkët. Shumica e personelit mësues jep mësim në të dyja programet. Si rrjedhojë e kësaj mbivendosjeje në mes këtyre dy programeve, brengat e shprehura dhe rekomandimet janë afërsisht identike dhe për këtë shkak duhet të trajtohen bashkërisht në këtë raport.

### 3.2.2 Të qenit në përputhje me Rekomandimet Pararendëse

Të gjitha çështjet e mëdha të akreditimeve pararendëse janë adresuar në mënyrë pozitive dhe janë zbatuar në mënyrë të suksesshme. Megjithatë, mbesin disa çështje:

- Rezultatet e pritura të mësimit nuk janë adresuar në mënyrë të duhur. Rezultatet e pritura të mësimit duhet të dallohen nga synimet. Rezultatet e mësimit të studentëve janë deklarata në lidhje me atë se çfarë pritet nga studenti të dijë, të kuptojë dhe/ose të jetë në gjendje të demonstrojë pas përfundimit të procesit të mësimit si dhe aftësitë specifike intelektuale dhe praktike të fituara dhe të demonstruara pas përfundimit të suksesshëm të një lënde, ose programi. Përderisa vëmendja në lidhje me rezultatet e pritura të mësimit duket se shfaqet vetëm në mënyrë formale, ajo duhet të konsiderohet si një instrument për sigurim të cilësisë që i mundëson menaxhimit të fakultetit të sigurojë një qasje të duhur didaktike të personelit mësues.
  - Rekomandohet që përveç përshkrimeve të lëndëve të bëhet përcaktimi i rezultateve të pritura të mësimit. Një përfaqësim i duhur i rezultateve të pritura mund të konsiderohet si rezultat i një procesi të planifikimit të detajuar mirë.
- Nuk është zbatuar Mësimi Elektronik. Sugjerohet që të bëhet një proces i zbatimit hap-pas-hapi, i nisur nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike. E-mësimi duhet të zbatohet me mbështetjen e personave me interes nga domeni i menaxhmentit apo ai edukativ, me synim që të evitohet problemet me pranimin e tij. Do të ishte e dobishme një fushatë e fuqishme informimi që do të adresonte përparësitë dhe problemet potenciale. Dohitet e e-mësimi mund të shfrytëzohen vetëm nëse ka personel të kualifikuar:
  - Rekomandohet që ky proces të mbështetet përmes përcjelljes së një specifikimi DIN (PAS 1032-1/2) në lidhje me "Edukim dhe Trajnim me Theks të Veçantë në e-mësim", që mund të shërbejë si udhëzues dhe si një listë kontrolluese.
  - Rekomandohet që fillimisht të zbatohet e-mësimi vetëm në këtë fakultet. Vetëm pasi të jetë mbledhur mjaft përvojë (pas afërsisht një viti të zbatimit)

- nga një zbatim i tillë pilot, atëherë mund të parashihet zgjerimi i e-mësimit në programet tjera.
- o Rekomandohet që të ofrohet material informativ në lidhje me e-mësimin, instruksionet dhe trajnimin për të gjithat grupet e shënjestruara (ligjëruesit, administratorët, studentët).

### 3.2.3 Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve

Sipas raportit pararendës mund të theksohet që programet akademike, që ishin kopjuar nga Universitetet e Shkencave Aplikative nga Austria, orrespondojnë me standardet ndërkombëtare. Ngjashëm me këtë, edhe kualifikimet akademike korrespondojnë me standardet ndërkombëtare. Mungesa e përfshirjes së disa kërkesave vendore ka shpjer në ngarkesë intelektuale të studentëve dhe të kapacitetit, ashtu siç ishte pritur. Si rrjedhojë, janë ndërmarrë masat dhe është zvogëluar numri i lëndëve në module për rreth 20%. Një masë e tillë kërkon procedura të duhura ligjore dhe komunikim të duhur me studentë. Kurrikula e ndryshuar në mënyrë të suksesshme ende korrespondon me standardet ndërkombëtare dhe reduktimi i diversitetit duket se ka qenë efektiv. Në kurrikulën e reviduar, më shumë rëndësi i është kushtuar Sigurisë së TI dhe Kompjuterisë Mobile që është bërë një vlerësim i zhvillimeve të tanishme të domenit të teknologjisë informative që është shumë dinamik dhe ky vlerësim është bërë në mënyrë profesionale. Çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë kanë fituar në rëndësi në mënyrë dramatike në kohën e tanishme të teknologjisë informative, në këtë mënyrë inxhinierët e ardhshëm do të duhej të kishin një kuptim të thellë të aspekteve relevante. Një kurrikulë moderne dot duhej të mbulonte të gjitha çështjet e mundshme që kanë të bëjnë me sigurinë, sigurimin, privacinë, enkriptimin dhe çështjet tjera ligjore.

#### Rekomandim i Ekspertit

Rekomandohet që të bëhet një vlerësim i vazhdueshëm i kurrikulës si rrjedhojë e natyrës dinamike të teknologjisë informative. Vëmendje e mjaftueshme do të duhej kushtuar çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë, kompjuterinë mobile dhe kompjuterin në re (serverë virtualë).

### 3.2.4 Mësimdhënie

Mësimdhënia vë theks mbi materialin mësimor tradicional dhe të bazuar në projekte dhe punë grupore. Ka disa laboratorë kompjuterikë që janë në funksion dhe që mundësojnë mësimdhënie praktike me pajisje moderne. Qasja në internet është e kërkuar në mënyrë që t'i qasesh literaturës dhe databazave online veçanërisht duke qenë se literatura që ka të bëjë me Teknologjinë Informative nuk është prezente fare në bibliotekë. Sipas vështrimit të studentëve, qasja në internet është mjaft e kufizuar edhe në laboratorin kompjuterik. Ky kufizim duhet të minimizohet duke qenë se universiteti do të duhej të shihej si një vend që mundëson qasje në resurse ndërkombëtare.

Është kuptuar se kompetencat e studentëve janë mjaft heterogjene, disa nga përpjekjet e studentëve kanë mungesë në seriozitetin e vet kjo sipas vlerësimit të vetë studentëve, Megjithatë, duket se personeli ka mbajtur marrëdhënie të shëndosha me studentët.

Arsimi i lartë përfiton potencialisht shumë nga përdorimi i e-mësimit, që duhet të adresohet në mënyrë specifike nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike. Zbatimi i e-mësimit kërkon (përveç zbatimit të infrastrukturës së TI) një konceptualizim të duhur të

mësimdhënies dhe të skenarëve të mësimi në nivelin didaktik makro, meso dhe mikro. Personeli akademik duhet të arsimohet në mënyrë të duhur sa i përket përmbajtjes teorike, aktiviteteve, mekanizmave të interaksionit, mjeteve të komunikimit dhe dizajnit.

#### Rekomandimi i Ekspertëve

Rekomandohet që

- Të mundësohet një qasje e vazhdueshme në internet në gjithë universitetin që konsiderohet si një tipar karakteristik i një institucioni arsimor modern.
- Të zbatohet (riaktivizohet) Sistemi i Menaxhimit të Mësimi (mundësisht në formë të një produkti të hapur siç është Moodle) që mundëson një qasje të ndërlidhur ndaj mësimi;
- Të zhvillohet dhe të zbatohet një koncept i mësimi elektronik (e-mësimi);
- Të ofrohet trajnim i mësimdhënësve në mënyrë që të sigurohej fakti që parimet e e-mësimi janë zbatuar në mënyrë adekuate.

### 3.2.5 Puna kërkimore

Në këtë aspekt në UIPz tani për tani nuk zhvillohet ndonjë hulumtim që reflekton situatën e përgjithshme të këtij universiteti. Megjithatë, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike duhet të demonstrojë një shpirt pionier kur bëhet fjala për hulumtimeve. Punët praktike mundësojnë punë kërkimore të përbashkët të bazuar në projekte me partnerët industrialë.

#### Rekomandimi i Ekspertëve

Rekomandohet ngritja e një strategjie në gjithë fakultetin sa i përket punës kërkimore dhe fillimi i punës kërkimore të bazuar në projekte me partnerët nga industria.

### 3.2.6 Personeli

Numri i personelit mësimor është rritur që nga viti i shkuar dhe duket se është në përputhje me të dyja programet. Sipas drejtorëve të programeve, personeli është i kualifikuar në aspektin profesional. Në krahasim me kualifikimet e mëhershme të personelit, numri i mësimdhënësve që bartin diplomë të doktoratës është rritur në mënyrë të ndjeshme. Sipas CV të prezantuara, afër një e treta e personelit mësimor mbajnë diploma doktorate, gati një e treta janë kandidatë PhD, dhe një e treta kanë diploma masteri, që dëshmon për një përmirësim të ndjeshëm në lidhje me kualifikimet. Nga 28 pjesëtarët e personelit mësimor vetëm dy janë me orar të plotë, 26 janë me orar jo të plotë. Mësimdhënësit me orar jo të plotë nxiten të vijnë nga universitetet tjera në Kosovë dhe më tej.

#### Rekomandim i Ekspertit

Rekomandohet që të punësohet personel akademik i permanent që paraqet si parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm dhe për aktivitete hulumtuese.

Rekomandohet që të riakreditohet Programi i Dizajnit të Softuerit.

Rekomandohet që të riakreditohet Programi Teknologji Informative dhe Telekomunikim.

Erwin Bratengeyer

Krems, 26.5.2012

### 3.3 Gjuhë dhe Letërsi Gjermane (riakreditim)

#### 3.3.1. Vërejtje hyrëse

Ishte për habi dhe zhgënjyes fakti që gjatë VNI nuk kishte pasur asnjë përfaqësues të departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të UiPz. Leximi i mëhershëm i RVV të departamentit ngriti mjaft pyetje në lidhje me personelin, programin e studimeve, etj. Për këtë arsye biseda direkte e planifikuar me përfaqësuesit e këtij departamenti ishte e nevojshme për rekomandimin e EE për procesin e akreditimit. Megjithatë, Prorektori i UiPz, Prof. Dr. Behxhet Mustafa, deklaroi se ky dështim procedural u shkaktua nga një keqkuptim në komunikim. Si rrjedhojë e kësaj, Prof. Dr. Zhushi-Etemi pyeti ekspertin për Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, Prof. Dr. Frederking, nëse ai do të pajtohej të zhvillohej një takim i jashtëzakonshëm me përfaqësuesit e departamentit të nesërmen në Prishtinë. Eksperti pranoi këtë propozim. Më datë 16 maj në ora 9 në mëngjes, Prof. Frederking, i shoqëruar nga Prof. Dr. Zhushi-Etemi e AAK, takoi katër përfaqësues të departamentit. Mes tyre ishte edhe udhëheqësi i programit të studimeve, Prof. Dr. Izer Maksuti. Mbi këtë bazë, Prof. Frederking ishte në gjendje të përpilonte raportin në vijim.

#### 3.3.2 Deklarata e Misionit

Është bindëse tërësia e synimeve të programeve në Gjuhën dhe Letërsinë Gjermane, të cilën e ka përpiluar departamenti. Është i mundur dallimi në mes dy alternativave kryesore (shkollimit dhe arsimimit). Vetë kurrikula është e strukturuar mirë dhe përmban aspektet kryesore të mësimdhënies së "Gjermanishtes si gjuhë e huaj". Janë zbatuar shumë nga rekomandimet e EE të qershorit 2011. Por ende ka nevojë për përmirësim.

##### Rekomandimi i Ekspertit

Do të duhej zhvilluar më tej perspektiva kërkimore që tashmë është cekur në raportin e qershorit 2011. Do të duhej intensifikuar përpjekjet në kërkim shkencor. Megjithatë, është e nevojshme të përmirësohet dukshmëria ndërkombëtare e departamentit. Urgjentisht do të duhej vënë në dispozicion në gjermanisht uebsajtin e departamentit të gjermanishtes.

#### 3.3.3 Liria Akademike

UiPz siguron lirinë akademike në punë kërkimore dhe në punë praktike. Megjithëse gjendja e tanishme financiare e universitetit nuk është e mirë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane do të duhej që në të ardhmen e afërt të kishte mundësinë të angazhonte një profesor të rregullt, kjo është edhe më urgjente nëse mëtohet që niveli i cilësisë së rezultatit shkencor të rritet më tej.

##### Rekomandimi i Ekspertëve

Menaxhmenti i UiPz do të duhej që të garantonte më tej aspektet praktike të lirisë në punë kërkimore dhe mësimdhënie. Profesorët dhe ligjëruesit e Departamentit të Gjuhës dhe

Letërsisë Gjermane do të duhej të përdornin këtë liri për të intensifikuar përpjekjet e tyre në lidhje me punën kërkimore. Në këto kushte, në të ardhmen Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane do të jetë një pjesë e rëndësishme e strategjisë së punës kërkimore në të gjithë Universitetin.

### 3.3.4 Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve

Siç është cekur në raportin e ekspertëve të 2011, programi akademik i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kurrikula e studimeve për Gjuhën dhe Letërsinë Gjermane është paraparë si një program BA katërvjeçar. Cilësia, shtrirja dhe synimet akademike të kurrikulës janë në përputhje me parimet e parapara në procesin e Bolonjës. Niveli akademik poashtu është në përputhje me këto standarde ndërkombëtare. Caktimi i kredive ECTS është i duhur dhe kuptimplotë. Ngarkesa e studentëve është e përbalueshme.

Ka kuptim që kurrikula dallon varësisht nga drejtimi: Arsim dhe Përkthim. Në dy vitet e para të gjithë studentët e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane duhet të kalojnë nëpër të njëjtat lëndë mësimore. Gjatë dy viteve në vijim, studentët me specializim në arsim dhe ata me specializim në përkthim duhet të zgjedhin lëndë specifike. Struktura, synimet dhe përmbajtja e këtyre lëndëve është e balancuar mirë. Thënë në përgjithësi, departamenti duket se është në rrugë të mbarë. Ky pohim konfirmohet nga përvoja e dy viteve akademike të para.

EE vlerëson faktin që personat që janë të ngarkuar me kurrikulën e Bachelor në Arte në Gjuhë dhe Letërsi Gjermane kanë ripërpiluar dhe specifikuar përmbledhjen e përmbajtjes së lëndëve në një mënyrë mjaft bindëse. Përshkrimi i lëndëve është i diferencuar dhe i qartë. Specialisti i propozuar dhe literatura teknike është mjaft e azhurnuar dhe përfaqëson nivelin e lartë të njohurive dhe të kapaciteteve mësimdhënëse. EE poashtu pohon faktin se shumë nga rekomandimet e EE të vitit 2011 tashmë janë realizuar në kurrikulën e re:

1. Është për t'u përsëritur fakti që kurrikula e re nuk i detyron studentët në lëndët e para për të filluar me literaturën mesjetare. Ka shumë më shumë kuptim që të ofrohet lënda "Hyrje në Literaturën Gjermane", siç bëhet përmes lëndës 1.4.
2. Është përparim i madh fakti që kurrikula e re ofron lëndë për didaktikë dhe për metodologji të Gjuhës Gjermane. Në këtë mënyrë optimizohet mundësia e kualifikimit të studentëve për profesionin e mësimdhënësit.
3. Duhet të theksohet një aspekt tjetër pozitiv, fakti që kompjuterët dhe interneti janë cekur në disa nga përshkrimet e lëndëve për arsim dhe përkthim.

Megjithatë, sa i përket kurrikulës ende vërehen ca probleme dhe çështje që ngrenë pyetje dhe nevojën për rekomandime.

#### Rekomandimi i Ekspertit

1) Është për t'u çmuar fakti që lënda "film" është përcaktuar si lëndë e veçantë dhe se Kompjuteri dhe Interneti është përmendur në disa prej përshkrimeve të lëndëve mësimore. Kjo korrespondon me pikëpamjen moderne. Por ende ka një boshllëk në kurrikulë që ka të bëjë me format e mësimdhënies dhe të mësimit të bazuara në internet dhe në kompjuter.



Kompjuterët dhe interneti ofrojnë mundësi të mëdha për përmirësimin e mësimin dhe të proceseve të mësimdhënies në raport me Gjuhën dhe Letërsinë Gjermane në të dyja fushat: në arsim dhe përkthim. Këto shanse të veçanta do të duhej shfrytëzuar.

2) Në kurrikulë do të duhej shtuar edhe librat audio, sepse ato ofrojnë mundësi për të mësuar edhe kode të tjera estetike.

3) Një tjetër aspekt i kurrikulës që do të duhej optimizuar është përmbajtja e kurrikulës për arsim. Veçanërisht literatura për fëmijë dhe të rinj do të duhej të ishte pjesë e kurrikulës, duke qenë se fëmijët kanë nevojë për literaturë që është në përputhje me moshën e tyre. Studentët e përqendruar në Arsim në Gjuhën dhe Letërsinë Gjermane duhet të kenë njohuri në këtë lloj të literaturës dhe të adaptimeve të saj mediale (audio-librave, filmave, etj).

4) Lëndët për didaktikë dhe metodologji të Gjuhës Gjermane duhet të plotësohen nga aspekti i literaturës. Kjo nënkupton se titulli i lëndës do të duhej të ishte: Didaktikë dhe Metodologji e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane. Përmbajtja do të duhej përshtatur.

5) Studentët duhet të kenë mundësi që vetë të përmirësojnë njohuritë e tyre të gjuhës. Për këtë qëllim është e nevojshme prezenca e laboratorit të gjuhës ose të softuerit specifik për studimeve të pavarura.

6) Përsëri, EE rekomandon që departamenti për "Gjuhë Gjermane" duhet të diskutojë në lidhje me atë nëse është strategji e mirë për të ofruar vetëm Bachelor. Ndoshta kjo ka kuptim në horizontin e pastër aplikativ. Mirëpo, një studim i nivelit master jep mundësinë për të ofruar një njohuri të detajuar shkencore që është në përputhje me standardin ndërkombëtar. Për këtë arsye, rekomandohet që nëse është e mundur, të ofrohet një studim i nivelit Bachelor 3 vjeçar dhe Master 2 vjeçar. Në këtë rast, lëndët për vitin e katërt të programit Bachelor (që tani janë vetëm në fazën e planifikimit) do të mund të shërbenin si bazë e vitit të parë të studimeve në nivelin Master.

### 3.3.5 Puna Kërkimore

Mundësitë për punë kërkimore në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane janë të kufizuara për shkak të faktit që i gjithë universiteti dhe departamentet e veçanta ende janë në proces të ngritjes. Megjithatë, departamenti do të duhej të zhvillonte strategjinë e punës kërkimore gjatë vitit në vijim. Cilësia e personelit duhet se paraqet një bazë të mirë për strategjinë e suksesshme të punës kërkimore.

#### Rekomandim i Ekspertit

Fokusi i punës kërkimore do të mund të ishte aspekti teorik i përkthimit në ndërlidhje me çështjet specifike rajonale të gjuhës dhe kulturës. Veç kësaj, një fokus i punës kërkimore i planifikuar do të mund të ishte ngritja dhe hetimi i koncepteve didaktike në fushën e "Gjermanishtes si Gjuhë e Huaj". Me qëllim që të përforcohen mundësitë faktike të punës kërkimore (por natyrisht edhe për të ofruar materialet për studentë), duhet të ndryshojë mungesa e tanishme e literaturës gjermane në bibliotekën e UiPz (shih raportin e përgjithshëm të EE).

### 3.3.6 Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar i departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane tani është i planifikuar në kontaktet personale të personelit. Ka bashkëpunim në mes universiteteve në Maqedoni, Austri dhe Gjermani.

#### Rekomandim i Ekspertëve

Është e qartë që Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane së pari është dashtë të përqendrohet në zhvillimin e strukturës dhe në përpilimin e lëndëve. Kjo do të jetë detyra kryesore e departamentit gjatë muajve në vijim. Megjithatë, do të duhej intensifikuar kontaktet ndërkombëtare dhe do të duhej zgjeruar ato në vendet dhe universitetet tjera. Është e nevojshme që Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të marrë pjesë në Projekte të BE në të ardhmen.

Duke qenë se në afërsi ka një gjimnaz bilingual (dygjuhësor) në Prizren (Gjimnazi Lajola) që pjesërisht financohet nga institucione dhe rrjete të ndryshme gjermane, rekomandohet të ketë një nivel të bashkëpunimit në mes Departamentit dhe atij gjimnazi. Departamenti do të mund të josit vëmendjen e një numri shtesë studentësh nga ai gjimnaz dhe do të mund të përfitonte nga punët praktike në fushën e arsimit dhe sa i përket partneriteteve të krijuara të shkëmbimit që gjimnazi Lajola ka me një numër gjimnazesh në Gjermani.

### 3.3.7 Personeli

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane tani ka tetë anëtarë. Ndër ta ka një profesor asistent dhe një profesor të asocuar. Dy pjesëtar të personelit janë duke punuar në PhD-të e tyre. Kjo paraqet një shenjë të cilësisë. Raporti numerik në mes 8 pjesëtarëve të personelit akademik dhe 204 studentëve është poashtu shumë i mirë. Por, departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane nuk ka një numër të duhur të personelit të rregullt.

#### Rekomandimi i Ekspertit

Është e nevojshme që Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të punësojë personel të rregullt, të paktën një profesor të rregullt, në këtë mënyrë do të mund të fillonte vazhdimësia dhe puna kërkimore.

Rekomandohet që të riakreditohet programi i studimeve në Gjuhë dhe Letërsi Gjermane.

Volker Frederking

Erlangen-Nürnberg 18.5.2012

### 3.4 Master në Trashëgiminë Kulturore dhe Menaxhim të Turizmit (akreditim i parë)

#### 3.4.1 Vërejtje të përgjithshme

Plani për të krijuar një program Master në Trashëgiminë Kulturore dhe Menaxhim të Turizmit rrjedh nga një projekt i Tempus-it dhe do të mund të konsiderohej si një hap i rëndësishëm për fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të UIPz (të financuar nga buxheti i BE) dhe fushës së shkencave sociale. Në mënyrë që kjo e fundit të zhvillohet më tej (që tani për tani është prezente vetëm falë prezencës së Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane) do të ishte e rëndësishme nga aspekti strategjik, kjo sepse do të mund të ofronte një mundësi reale për zhvillim të fuqishëm të punës kërkimore në UIPz.

Megjithatë, siç mund të shihet nga kapitulli në fjalë i raportit të vlerësimit, ende ka nevojë për përmirësime të rëndësishme në programin e nivelit Master në mënyrë që të mundësohet një punë e suksesshme.

RVV ka ofruar një informacion bazik të dobishëm në lidhje me programin e nivelit master, gjatë VNI që e mundur të shtohen aspekte të rëndësishme si rrjedhojë e diskutimit me menaxherin e programit Prof. Behxhet Brajshori (Prorektori për administratë ishte i pranishëm poashtu) dhe falë planprogramit të programit që është dërguar si rrjedhojë e kërkesës pas VNI. Megjithatë, duhet cekur se këto planprograme që ishin dërguar kanë mbuluar vetëm disa pjesë të programit, veçanërisht pjesët që kishin të bënin me ekonominë. Mungonin gati të gjitha planprogramet nga fushat tjera të shkencave sociale përveç atyre të ekonomisë.

#### 3.4.2 Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentëve

Bazuar në përgjigjet e dhëna në VNI programi fillimisht ishte zhvilluar sipas nismës së përfaqësuesve të shkencave sociale të përfshirë në program, nga arkeologjia, antropologjia dhe në një masë edhe nga historianët. Siç u pa, një nga partnerët ndërkombëtarë (Universiteti Chieti, Itali) ka luajtur një rol kryesor, që në këtë rast mund të fuqizohet më tej nga një anim drejt arkeologjisë. Programi i përpiluar dhe multidisiplinar i nivelit master është prezantuar si synim për edukim të menaxherëve profesionalë dhe promovuesve të trashëgimisë kulturore dhe turizmit. Megjithatë, turizmi si i tillë u tha që nuk ishte fokus i programit, të paktën jo kur ngrihet pyetja se pse fushat specifike të shkencave humane janë zgjedhur dhe disa të tjera mungojnë. Unë do t'i referohem problemeve konceptuale që janë të ndërlidhura me këtë në disa paragrafët e mëvonshme të këtij kapitulli.

Si i tillë, programi akademik do të mund të konsiderohej si i përpiluar në mënyrë të duhur, si një përzierje në mes aspekteve të shkencave humane, studimeve të mjedisit dhe ekonomisë. Numri i lëndëve mësimore është i duhur dhe ngarkesa në punë është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Numri i kufizuar i studentëve (vetëm 25-30 për vit) duket se është i duhur për kërkesat e tregut të punës në Kosovë, në këtë mënyrë do të mund të ofronte një raport numerik të shkëlqyeshëm në mes studentëve/mësimdhënësve.

Megjithatë, në lidhje me konceptin akademik ende mbetet një pikë e dobët me rëndësi. Kjo ndërlidhet para së gjithash me përfaqësimin e shkencave humane, që duket se janë

zgjedhur në mënyrë arbitrare. Si rrjedhojë, ato janë disi të nënpërfaqësuar në program. Përderisa Kosova ka vende arkeologjike të rëndësishme për gjurmime, kjo vështirë se mund të vihet në fokus të zhvillimit të ardhshëm të turizmit në rajon. I njëjti kufizim vlen edhe për fushën e antropologjisë. Në kontrast me këtë, trashëgimia e artit islam si dhe ajo më e famshme duke qenë së është pjesë e listës së trashëgimisë botërore të UNESCO-s, pra arti dhe arkitektura ortodokse duhet të jenë në fokus të çfarëdo strategjie të ndërlidhur me kulturën, qoftë në praktikë apo në arsimim. Në mënyrën se si është përpiluar programi tani, kjo fushë është e reflektuar nga programi në mënyrë skajshmërisht të pamjaftueshme. Është paraparë vetëm një lëndë mësimore në "Arkitekturë dhe në Trashëgimi Artistike" (lënda A 3), ndërsa studentët kanë nevojë për lëndë qoftë në arkitekturë dhe art islam dhe të krishterë ortodoks. Nëse shihet më nga afër informacioni i dhënë në RVV, e vetmja referencë ndaj trashëgimisë ortodokse është bërë në lëndën e përmendur A.3, dhe aty ceket vetëm me termin "Ndërtesat Bizantine". Në këtë kontekst, mospërmendja e trashëgimisë kulturore serbo ortodokse bie ndesh në mënyrë direkte me synimin e universitetit për të paraqitur multietnicitetin e Kosovës dhe të rajonit të Prizrenit. Kjo zgjedhje shfaq siç është cekur edhe më herët, një mungesë të fuqishme të reflektimit ndaj aseteve ekzistuese turistike, të cilat duhet t'i adresojë programi.

Nëse shihet më nga afër materiali i planprogramit (jo i plotë) i dërguar pas kërkesës së veçantë, fuqizohet edhe më tej përshtypja se programi nuk është ende mjaft i balancuar dhe i zhvilluar. Disa nga planprogramet duket se janë ndërtuar sipas metodës copy/paste (planprogrami për "Marketingun e Turizmit", ligjëratat 9, duke përfshirë "Pushimet Ndërkombëtare të shkurtra në Britani të Madhe dhe në Evropë", që kanë kuptim vetëm në një planprogrami universitar për turizmin në Britani të Madhe, program nga i cili mund të jetë kopjuar ky material). Përndryshe, programi bindës për "Resurse Natyrore dhe Planifikim Hapësinor" kërkon leximin e dy titujve që i referohen "Konservimit të natyrës detare në Mbretëri të Bashkuar" rëndësia e të cilës vjen si surprizë duket pasur parasysh se në Kosovë nuk ka një mjedis detar. Sigurisht se nuk mund të pritet që një lëndë e vetme mësimore të ketë potencial që të pritet nga ajo t'i ofrojë studentëve të nivelit master mundësinë për të fituar jetesën e tyre si praktikientë në punën e restoracionit të veprave artistike, siç është lënda "Konservimi dhe Restorimi i Trashëgimisë Kulturore").

#### Rekomandimi i Ekspertëve

Programi do të duhet të ishte punuar në mënyrë më të detajuar dhe i strukturuar më mirë. Pësha e shkencave humane duhet të rritet dhe ka nevojë që ajo të jetë e zgjedhur në mënyrë të duhur.

#### 3.4.3 Mësimdhënia

Duke parë që planprogrami (që ofron ekskursione shtesë ndaj mësimdhënies tradicionale, etj) dhe strukturën e mirë sa i përket raportit numerik në mes studentëve/mësimdhënësve, mësimdhënia e paraparë e programit duket të jetë e duhur. Megjithatë, nuk ka një koncept të dukshëm sa i përket përfshirjes në pamje të parë të madhe të ligjëruesve të shumtë të jashtëm të cekur në RVV, ose mënyrës se si ata do t'i kontribuonin në mënyrë efektive mësimdhënies. Qasja në internet do të kërkohet në mënyrë që t'i qasen literaturës, veçanërisht sepse dyshohet se biblioteka ekzistuese nuk ofron asgjë në lidhje me fushat e studimit të përfshira në program.

Ofrimi i Programit Master do të mund të ofronte në atraktivitet të shuar për UIPz në garë me institucionet tjera në rajon, si dhe mund të ofrojë një perspektive më të mirë për

studentët më të talentuar të vetë Universitetit pasi që ata të kenë përfunduar studime të ndryshme në nivelin bachelor.

#### Rekomandimi i Ekspertit

Rekomandohet që

- të mundësohet qasja në gjithë universitetin e internetit, që konsiderohet si tipar karakteristik i çfarëdo institucioni modern.
- të ngrihet strategjia për përfshirjen e ligjëruesve të jashtëm.

#### 3.4.4 Puna kërkimore

Siç është indikuar, programi do të mund të ndihmonte në fuqizimin e shkencave humane në UiPz dhe në këtë aspekt të kontribuonte në fuqizimin e kapaciteteve hulumtuese në këtë institucion, duke ditur se puna kërkimore në shkencat humane nuk kërkon shumë mjete financiare. Aspekti i fuqishëm i bashkëpunimit ndërkombëtar brenda programit Tempus mund të jetë i dobishëm më tej për zhvillimin e punës kërkimore. Disa nga ligjëruesit e paraparë tashmë kanë historik të bindshëm si hulumtues (veçanërisht në mes të personelit mësimor në fushën e arkeologjisë).

#### Rekomandimi i Ekspertit

Programi do të duhej të zhvillohej si një aset strategjik për rritjen e kapaciteteve të punës kërkimore në UiPz, veçanërisht në fushën e shkencave humane.

#### 3.4.5 Personeli

Brenda këtij programi është paraparë që 6 mësimdhënës (Brajshori, Gjini, Mustafa, Rogova, Sopjani dhe Zymberaj) të jenë me orar të plotë në UiPz (shumica nga departamenti i ekonomisë) që do të paraqiste një dallim pozitiv ndaj programeve ekzistuese në nivelin bachelor që vuajnë nga një numër i madh i mësimdhënësve me orar jo të plotë. Disa nga personeli mësimdhënës të cekur në RVV japin një standard të lartë të punës kërkimore.

Megjithatë, ishte për t'u habitur fakti që kuptuam gjatë VNI se lista e mësimdhënësve e ofruar në RVV nuk ishte e azhurnuar, disa nga emrat e cekur ishin të panjohur për menaxherin e programit. Shpjegimi i dhënë thoshte se këta emra ishin vënë në mënyrë të njëanshme nga ana e rektorit të UiPz, që në fakt paraqet mënyrën se si nuk do të përpilohej lista, nëse mëtohet të reflektohen standardet profesionale. Për ne ishte një surprizë negative të kuptojmë që në një masë të madhe lista e ligjëruesve të ftuar ishte dërguar nga partnerët e Tempus-it nga Chieti, pa një shkëmbim të mëtejshëm të profilit dhe të historikut të ligjëruesve. Gjatë VNI nuk qe e mundur të ofroheshin informata në lidhje me këta persona.

#### Rekomandimi i Ekspertëve

Rekomandohet të ripërpilohet lista e ligjëruesve sipas udhëzimit të bërë nga menaxheri i programit.

Programi Master në Trashëgimi Kulturore dhe Menaxhim Turizmi nuk rekomandohet ende që të bëhet akreditimi i tij. Programi do të mund të bëhej shumë më i bindshëm pas ndryshimit të tij dhe rekomandohet që ai të përgatitet për rikonsiderim gjatë procesit të radhës për akreditim.

Konrad Clewing

Regensburg, 30.5.2012

## 3.5 Programi Drejtësi (BA) në universitetin publik të Prizrenit

### 3.5.1 Hyrje

Raporti i vlerësimit në vijim ka të bëjë me programin në drejtësi (BA) të Universitetit Publik të Prizrenit (UiPz) dhe është bazuar në raportin e vetë-vlerësimit të këtij institucioni që përfshin disa anekse. Përveç RVV, EE i është dërguar edhe një listë e anëtarëve të personelit dhe CV-të e tyre.

Raporti i vlerësimit në vijim reflekton edhe rekomandimet e vlerësimit të zhvilluar në vitin 2011.

### 3.5.2 Kurrikula

Programi në drejtësi është një program BA prej 8 semestrave (cikli i parë) sipas arkitekturës së Bolonjës. Në fund të programit fitohet diploma akademike "Bachelor në Drejtësi LLM, BA". Në këtë program jepen 220 kredi ECTS në lëndët mësimore, 20 kredi për tezën e diplomës, gjithsej 240 kredi. Sa i përket sasisë së pikëve përmbushet arkitektura e Bolonjës.

Pasqyra e dhënë në faqen 7 të RVV flet për "modulet/lëndët". Në arkitekturën e Bolonjës modulet përbëhen nga disa lëndë. Kjo nuk vlen për kurrikulën respektive, për këtë arsye do të duhej përdorur vetëm nocioni "lëndë mësimore".

Synimet e programeve janë të fitohet një njohuri e përgjithshme juridike që shërben si bazë për specializim të mëtejme në fushat e ndryshme. Veç kësaj, programi mëton të ofrojë një kuptim interdisiplinar të drejtësisë, të ndërlidhë aspekte të ndryshme dhe fusha të drejtësisë dhe të kontekstit të saj social. Është përmendur fakti se mësohen edhe gjuhë të huaja. Një nga synimet e mësimin janë edhe aftësitë akademike, që janë në përputhje me nevojat e tregut. Veç kësaj, të diplomuarit do të kenë aftësi të shprehura të komunikimit, verbal dhe atij të shkruar.

Është për t'u vënë në diskutim nëse programi është në përputhje me synimet e cekura më sipër. Dy kërkesa duhet të nxirren nga synimet e cekura.

Së pari, duhet të jetë e theksuar pjesa e mësimin praktik e analizimit të rasteve konkrete në drejtësi dhe zgjidhje e problemeve ligjore në secilën lëndë. Përmbledhja e përmbajtjes së lëndëve mësimore i referohet kohë pas kohe studimeve ose projekteve të studentëve. Ende është e paqartë se çfarë nënkuptohet nga studimet e rastit dhe projektet. Do të ishte e nevojshme të formulohet një rast i veçantë që duhet dhe mundet të zgjidhet nga studentët nën udhëzimin e ligjëruesve. Veç kësaj, synimi i "kuptimit interdisiplinar" mund të arrihet përmes analizimit të rasteve ligjore dhe zgjidhjes së problemeve legale; zakonisht degë të ndryshme të drejtësisë janë relevante për rastet ose problemet (që fokusohen në rastin konkret) dhe mund të tregohen aspektet politike, sociale, ekonomike të rregulloreve ose të zgjidhjeve të rastit.

Synimi kryesor i ciklit të parë të arkitekturës së Bolonjës është që mbështesë punësimin e të diplomuarve. Programi nuk indikon objektivin e vet. Mund të ushtrohen shkathtësitë respektive. Nëse lexohen synimet dhe qëllimet e programeve dhe shikohet përmes kurrikulës, duket të jetë e qartë, sidomos sa i përket zgjatjes së programit, që programi

në të shumtën është i orientuar drejt aftësisë të diplomuarve të regjistruar në programin master.

Në kapitullin "përmbledhje e përmbajtjes së lëndëve" në RVV mungojnë udhëzimet, se cilat lëndë jepen në gjuhë të huaj. Udhëzimi do të duhej të ishte pjesë e planprogramit. Si rrjedhojë e faktit, ishte vënë në dispozicion vetëm planprogrami në lëndën "kontabiliteti i shpenzimeve", nuk mund të vlerësohet se si mund të arrihet synimi respektiv.

Padyshim që synimi "shkathësitë në komunikim", si ato verbale apo të shkruara janë të rëndësishme, veçanërisht për profesionistë në fushën e drejtësisë që duhet të debatohet në mes rasteve dhe mënyrave të ndryshme të zgjidhjeve dhe të cilët duhet t'i përpilojnë rregulloret dhe zgjidhjet e rasteve të kuptueshme për personat e përfshirë. Nëse hidhet një vështrim në RVV nuk është e qartë se si arrihet ky synim. Shkrimi legal është një lëndë zgjedhore. Duhet të transferohet në lëndën obligative (ndoshta në vend të së Drejtës Ndërkombëtare Penale, që është lëndë obligative). Në një lëndë të tillë, do të duhej të ushtrohej edhe shkrimi i tezës.

Formulimet e rasteve të veçanta do të mund të bëheshin në bashkëpunim me institucionet (gjykatat, organet administrative, organizatat shoqërore, bizneset, etj). Me një bashkëpunim të tillë mund të arrihen disa objektiva. "Bota e jashtme" në raport me institucionin mund të interesohet në lidhje me atë se çfarë po bën universiteti, studentët përballen me problemet "reale" dhe studentët, sidomos ata në semestrat e fundit, kanë ca informata se cilat institucione mund të adresohen kur ata kërkojnë punë.

Një nga rekomandimet e dhëna në raportin e fundit të vlerësimit ishte që Lënda mbi Të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare (një lëndë zgjedhore) të shndërrohej në lëndë të detyrueshme. Programi i tanishëm i drejtësisë përmbush këtë rekomandim. Një rekomandim tjetër ishte që E drejta mbi Procedurën Administrative do të duhej fokusuar mes tjerash në të drejtat e qytetarëve për të marrë pjesë në procedurën administrative dhe në kontrollin e vendimeve të administratës. Në përshkrimin e lëndës "Procedura Administrative", janë cekur "personat me interes". Fatkeqësisht, rekomandimi i parë nuk është marrë parasysh.

Një aneks i RVV është planprogrami i lëndës "Kontabiliteti i Shpenzimeve". Mund të bëhen komentet në vijim.

Së pari, nuk është e qartë nëse planprogrami është i përpiluar për të gjitha lëndët dhe veçanërisht për lëndët brenda programit të drejtësisë. Veç kësaj, planprogrami i tanishëm përmban disa shifra të paqarta: Dy orë ligjërata në javë në pesëmbëdhjetë javë nuk arrijnë në 45, por në 30. Veç kësaj, nuk mund të përcillet llogaritja e ngarkesës (shih rreshtat që flasin për kohën e vetë-studimit dhe të përgatitjes përfundimtare për provim). Siç ishte cekur në raportin e vlerësimit të vitit 2007, rezultatet e mësimit do të duhej strukturuar në kuptimin e "njohurive, kompetencave dhe aftësive". Gjatë vizitës në institucion në vitin 2011, u vu në dispozicion një përshkrim i lëndës tek drejtori i atëhershëm i programit.

Në raportin e vlerësimit të vitit 2011 është rekomanduar që e Drejta e BE do të duhej të integrohej në lëndët mësimore brenda lëndëve respektive të drejtësisë, kjo duke shtuar një lëndë të veçantë që trajton të Drejtën e BE. E Drejta e BE është pjesë e programit, por ende nuk mund të vlerësohet nëse është përmbushur rekomandimi që trajton integrimin e të Drejtës së BE në lëndët mësimore.



### 3.5.3 Personeli

Në RVV thuhet se për programin janë përgjegjës 16 ligjërues. Janë paraparë 247 vende në studim. Duke marrë parasysh që ata 16 nuk janë vetëm të angazhuar në programin e dorëzuar, por edhe në programe që tashmë janë akredituar, duket se është gati e pamundur që numri i studentëve të trajtohet në mënyrën e duhur. Veç kësaj, është thënë se me orar të plotë është vetëm një profesor asistent. Për këtë arsye, rekomandimi i bërë në raportin e vlerësimit 2011 duhet të përsëritet: Duhet të bëhen përpjekje të bindshme që të rritet numri i personelit mësimor, respektivisht numri i personelit të rregullt të angazhuar.

Megjithatë, duhet të ceket që të gjithë ligjëruesit që janë të cekur si bartës të lëndëve janë bartës të titullit PhD. Për këtë arsye, ata mund të jenë përgjegjës për lëndët me një cilësi të lartë. Veç kësaj, duhet të ceket se udhëheqësi i këtij programi të studimit është një profesor asistent (i angazhuar me orar të plotë) që mban diplomë nga Universiteti i Gracit dhe nga Universiteti i Jenës që ka punuar si asistent në Fakultetin e Drejtësisë në Tübingen.

### 3.5.4 Propozim për vendimin për akreditim

Duke marrë parasysh problemet në një vend që në një mënyrë apo tjetër është ende në fazë tranzicioni, nevoja për zgjerimin e mundësive për rininë për të ndjekur arsim të lartë në institucione dhe për kualifikim të anëtarëve të personelit akademik që janë të përfshirë në programin e drejtësisë, unë propozoj që të akreditohet programi i dorëzuar në drejtësi.

Em.O. Univ.-Prof. Dr. Christian Brünner  
Universiteti i Gracit  
Graz, 31 maj 2012